



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES
DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
SEKTORI I ASETETEVE

PROJEKT VENDIM

Nr 6. Datë 13.01.2023

Për miratimin në parim të dhënies me qira për veprimtari bujqësore, të sipërfaqes prej 0,52 Ha, pjesë e pasurisë nr 37, Zk nr 1100, e llojit “Arë”, fshati Barbullush, NJAD Bushat, Bashkia Vau Dejës.

Bazuar në nenin 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/1” (ndryshuar), neni 55 pika 4, të ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligji nr 38/2019, ligji nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr 246, datë 31.03.2011, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr 68, datë 28.01.2008, për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës”, ligji nr 8312, datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, VKM nr 531, datë 21.08.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, ligji nr 8752, datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, Udhëzimi nr 1, datë 18.07.2012, “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, propozojmë që në mbledhjen e radhës, Këshilli Bashkiak të:

VENDOSI :

1. Dhënie pëlqimi në parim për dhënien me qira të sipërfaqes prej 0.52 Ha, të pasurisë nr 37, Zk nr 1100, e llojit “Arë”, në fshatin Barbullush, Nj.Ad Bushat, Bashkia Vau Dejës, e cila mund të përdoret për veprimtari bujqësore, sipas kërkesave të subjekteve të interesuar.
2. Efektet: Jep impakt pozitiv në komunitet duke hapur vende të reja pune, si dhe sigurohen të ardhura për Bashkinë, që kthehen më pas në investime publike.
3. Tarifa e qirasë vjetore dhe afati i dhënies me qira të jetë në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr 1, datë 18.07.2012, “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”.

KRYETARI
Mark BABANI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARI

Kristian SHKRELI



Konceptoi: Armand Filipi
Miratoi: Ndoc Baqli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
SEKTORI I ASETETEVE

RELACION

DHËNIE NË PËRDORIM TË PASURISË SHTETËRORE E LLOJIT "ARË" ME SIPËRFAQE PREJ 0,52HA, NË FSHATIN BARBULLUSH.

Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Vau Dejës, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, ndër të tjera ka edhe administrimin dhe shfrytëzimin e resurseve të saj, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, posaçërisht të kaluara në pronësi të saj, me qëllim dhënien në përdorim të tretëve, me objektiv për të siguruar të ardhura për bashkinë, që më pas kthehen në investime publike, si dhe duke hapur vende të reja pune me impakt zbutjen e varfërisë dhe për rrjedhojë rritjen e cilësisë së jetës në komunitet.

Mirëadministrimi i Aseteve publike, është një pjesë e rëndësishme e qeverisjes lokale të mire. Me transferimin e pronave të paluajtshme publike shtetërore në administrimin vendor menaxhimi i asetëve publike bëhet një përgjegjësi e rëndësishme vendore në shërbim të shpërndarjes së zhvillimit ekonomik në të gjithë territorin e Bashkisë.

Bazuar në ligjin nr 139/2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, ligjin nr 8744 "*Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit, në njesitë e qeverisjes vendore*", ndryshuar, Bashkia jep në përdorim subjekteve të interesuar, pasuritë e paluajtshme në pronësi të saj, me kontratë qiraje, sipas procedurave përkatëse. Bazuar në Udhëzimin nr 1, datë 18.07.2012 "*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*", objekt i këtij udhëzimi janë tokat e regjistruara si të tilla në regjistrat kadastralë dhe që kanë qenë në përbërje të ish kooperativave bujqësore, por që kanë mbetur pa u ndarë sipas ligjit nr 7501, datë 19.07.1991, "*Për token*". Këto pasuri jepen me qira sipas udhëzimit të mësipërm, me afate kohore sipas planit të biznesit dhe llojit të veprimtarisë bujqësore që do të ushtrohet nga ana e subjektive të interesuar. Objekt i qiradhënies së tokës bujqësore është një pjesë e pasurisë nr 37, Zk nr 1100, në fshatin Barbullush, me sip 0.52 Ha. e llojit "Arë".

Nga ASHK, Drejtoria Vendore Shkodër kemi nxjerrë Kartelën e Pasurisë së Paluajtshme dhe Fragment të hartës Kadastrale të pasurisë nr 37, Zk nr 1100, ku rezulton se është pasuri e llojit "ARË", ndodhur në fshatin Barbullush.

Bazuar në Udhëzimin nr 1 datë 18.07.2012, "*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*", pasuritë e llojit "ARË" jepen në përdorim vetëm për zhvillimin e aktiviteteve bujqësore.

Pas miratimit në Këshillin Bashkiak, dhe shprehjes së ligjshmërisë nga ana e Prefektit të Qarkut, vazhdon procedura me të gjithë elementet shpalljes, kërkesave dhe konkurimit me të gjithë elementet e saj përbërës deri në shpalljen e subjektit fitues dhe lidhjen e kontratës së qirasë, konform kontratës TIP për dhënie me qira të tokave bujqësore të pandara.

Për sa më sipër, ju ftojme për të miratuar këtë Projekt Vendim.

Hartuesit e Relacionit

Ndoc Baqli



Armand Filipi



Ilda Prendi



**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/KRYETARI
Kristian SHKRELI**

**KRYETARI
Mark BABANI**

